

VENDIM
Nr. 121, datë 1.12.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FATLUM”
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“PERROLLAJ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fatlum” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se,

Aplikimi i shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1,
Formati i plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2
Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 3
Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, 4.1.3) janë plotësuar në mënyrë korrekte.
(Dokumentacioni teknik neni 9, pika 4.1.3 është plotësuar korrekt.
- Neni 9, pika 4.1.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik është plotësuar pjesërisht.
(Mungon plani i biznesit.)

- Leje nga institucione të tjera. (Neni 9, pika 4.4.5) është plotësuar tërësisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Perrollaj”, fuqia e instaluar 0,5 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti